

Në rrjetet sociale po qarkullon një video ku besohet se Mirsad Ndrecaj (në anën e djathtë të fotos) e thirr ezanin në një xhami. Ndrecaj bashkë me Beg Rizajn janë dy luftëtarët më të përfolur ditëve të fundit për betejën e Kumanovës.

Mirsad Ndrecaj i njohur si komandant NATO dhe Beg Rizaj i njohur si komandant Begu deri dje kanë rezultuar të zhdukur, por dje u konfirmuar se ata të dy janë mesin e 10 të vrarëve në Lagjen e Trimave në Kumanovë, në luftimet 32 orësh me forcat maqedonase.

Ndrecaj vije nga Komuna e Gjakovës dhe ka qenë pjesëmarrës në tri lufta, atë të Kosovës, të Luginës së Preshevës dhe të Maqedonisë. /io/